

## Thirrje e hapur për 14 bashki nën programin “BE për Kujdesin Social”

Njoftojmë se është shpallur thirrja për projekt propozim për 14 bashkitë përfituese, nën programin “BE për Kujdesin Social” (EU4SocialCare). Programi “BE për Kujdesin Social” financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Unicef Shqipëri dhe World Vision Albania, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Qëllimi kryesor i thirrjes është të mbështesë pushtetin vendor për të forcuar ofrimin e shërbimeve të kujdesit social me bazë komunitare dhe të specializuar në partneritet me organizatat e shoqërisë civile (OSHC).

Thirrja i drejtohet 14 bashkive të përzgjedhura (Gjirokastrë, Vorë, Cërrik, Librazhd, Kavajë, Kurbin, Kukës, Krujë, Pogradec, Korçë, Kamëz, Vlorë, Elbasan, Durrës) dhe organizatat e shoqërisë civile, që të aplikojnë për financim të projekteve që do të mbështesin përmirësimin dhe zgjerimin e shërbimeve të kujdesit social në Shqipëri.

**Aplikantët:** Bashkitë dhe Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC) që ofrojnë shërbime të kujdesit social. Bashkitë e synuara dhe OSHC-të që ofrojnë shërbime të kujdesit social kanë të drejtë të aplikojnë. Inkurajohen aplikimet e përbashkëta ndërmjet bashkive dhe organizatave të shoqërisë civile (OSHC).

**Fondi për Secilin Grant:** 60,000 EUR - 200,000 EUR

**Kohëzgjatja e Zbatimit:** 8 deri në 18 muaj

Thirrja është e ndarë në 2 LOT-e:

### **LOT 1: Krijimi dhe/ose zgjerimi i shërbimeve të bazuara në komunitet**

Objektivi i LOT I është të mbështesë krijimin dhe/ose zgjerimin e shërbimeve të kujdesit social me bazë në komunitet në partneritet me organizatat e shoqërisë civile me përvojë në ofrimin dhe mbështetjen e shërbimeve të përgjegjshme gjinore në nivel bashkie.

### **LOT 2: Krijimi/ose zgjerimi i shërbimeve të specializuara**

Objektivi i LOT II është të mbështesë krijimin dhe/ose shtrirjen e shërbimeve të specializuara të kujdesit social që synojnë nevoja specifike në maksimum 3 bashki që ndodhen afër njëra-tjetrës. Shërbimet e propozuara mund të trajtojnë: Shërbime të specializuara të urgjencës për fëmijët dhe/ose gratë viktime të dhunës; Shërbime të specializuara për fëmijët me aftësi të kufizuara (Çrregullimi i Spektrit të Autizmit, ADHD, etj); Shërbime të specializuara të shëndetit mendor; Shërbime të specializuara për viktimat e trafikimit; Shërbimet e orientimit dhe mbështetjes në karrierë për të rriturit me aftësi të kufizuara; Shërbimet e mbështetjes familjare dhe kujdestarisë për fëmijët në rrezik ndarjeje dhe/ose qëndrimi në kujdesin rezidencial.

### **Aplikantët e kualifikuar për të aplikuar:**

#### **Bashkitë:**

- Duhet të jenë një nga 14 bashkitë e synuara.
- Në rastet kur një bashki do të jenë aplikanti kryesor, ajo duhet të jetë drejtpërdrejt përgjegjëse për përgatitjen dhe menaxhimin e projektit me bashkë-aplikuesin(ët), jo duke vepruar si ndërmjetës.

#### **Organizatat e shoqërisë civile (OSHC):**

- Duhet të jetë person juridik aktiv.
- Duhet të jetë një organizatë jofitimprurëse, e regjistruar dhe që vepron ligjërisht në Shqipëri (në përputhje me ligjin nr. 8788, datë 07.05.2001, i ndryshuar).
- Në rastet kur një OSHC do të jenë aplikanti kryesor, ajo duhet të jetë drejtpërdrejt përgjegjëse për përgatitjen dhe menaxhimin e projektit me bashkë-aplikantin(ët), jo duke vepruar si ndërmjetës;
- OSHC që kanë përvojë të mëparshme në zbatimin e granteve të ngjashme në fushëveprim dhe objektiva.

**Kritere të Përzgjedhjes**

1. Kapaciteti dhe përvoja e aplikantit në ofrimin e shërbimeve sociale.
2. Rëndësia dhe ndikimi i propozuar i projektit në komunitet.
3. Qëndrueshmëria financiare dhe burimet e disponueshme për zbatimin e projektit.
4. Bashkëpunimi me partnerë lokalë dhe aktorë të tjerë relevantë.

**Afati i fundit i aplikimeve:** 15 shtator 2024

Bashkitë do të aplikojnë duke dërguar materialet e nevojshme të aplikimit në adresën:  
**eu4socialcare@unicef.org**

Organizatata e Shoqërisë Civile do të aplikojnë përmes portalit (United Nations Partner Portal).

Për më shumë informacion mund të konsultoni linket:

<https://wcmprod.unicef.org/albania/suppliers-and-service-providers#:~:text=The%20deadline%20for%20Clarification%20Request%20is%2023%20August%2024%2C%2023%3A59%20hours.>

ose

<https://worldvision.al/zgjerimi-i-sherbimeve-te-kujdesit-social-eu4socialcare-shpall-thirrjen-per-projekt-propozime/>